



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M
Nr. 66, datë 30.10.2017

**PËR RISHPËRNDARJE TË FONDEVE TË TRASHËGUARA TË BUXHETIT TË
VITIT 2016 DHE FONDEVE TË BUXHETIT TË VITIT 2017 TË BASHKISË
SHKODËR**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.10.2017, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenet 23 pika 11, 54 shkronja “dh”, 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 130 datë 15.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, nenin 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 45 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 2 datë 06.02.2012 “Mbi procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, VKB nr.8, datë 30.01.2017 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2017 të Bashkisë Shkodër”, VKB nr. 48, datë 03.08.2017 “Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2016 të Bashkisë Shkodër”, relacionin nr. 339 prot, datë 29.8.2017 të Drejtorisë Ekonomike të Arsimit, me 33 vota pro,

V E N D O S I :

1. Të miratojë rishpërndarjen ndërmjet programeve dhe artikujve të fondeve të buxhetit të vitit 2017, dhe të fondeve të trashëguara nga viti 2016, sipas pakësimeve dhe shtesave të pasqyruara në tabelën 1, bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miraturar në datën 30.10.2017
Shpallur në datën 31.10.2017

Sekretar i këshillit

Suel Hadri

KRYETAR


Xhemal BUSHATI

TABELA 1

Pakësime				Lekë	
Nr Programi	Programi	Emërtimi	Totali	Mallra dhe Sherbime/602	Shpenzime Kapitale të Trupëzuara/231
9230	Arsimi Parauniversitar , i mesëm i përgjithshëm	P9.F1.F2.O1.A4 Mirëmbajtje e zakonshme e objekteve arsimore të Bashkisë Shkodër viti 2017	1,496,350	1,496,350	
9120	Arsimi Parauniversitar , i mesëm i përgjithshëm	P9.F1.F2.O2.A9 Rikonstruksion i pjesshëm shkolla "Tringe Smajla" Fshati Grudë e Re Njësia Administrative Rrethina-viti 2016	2,075,880		2,075,880
9230	Arsimi Parauniversitar , i mesëm i përgjithshëm	P9.F1.F2.O2.A8 "Rikonstruksion i plotë shkolla Oso Kuka"viti 2016	2,990,000		2,990,000
TOTALI			6,562,230	1,496,350	5,065,880

Shtesa				Lekë	
Nr Programi	Programi	Emërtimi	Totali	Shpenzime Kapitale të Patrupëzuara/230	Shpenzime Kapitale të Trupëzuara/231
9230	Arsimi Parauniversitar , i mesëm i përgjithshëm	P9.F1.F2.O2.A8 "Rikonstruksion shkolla Oso Kuka-Faza II- viti 2017	6,562,230	221,000	6,341,230
TOTALI			6,562,230	221,000	6,341,230

Sekretar i këshillit



Suel Hadri

KRYETAR



Xhemal BUSHATI

